



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primiheño/Prodato Received/Delivery	28.10.2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ./Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHK	6525/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.821/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.821/2022 të datës 23.09.2022, të parashtruar nga grupi i ankuesve:

dhë të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë banimi Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.821/2022, e datës 23.09.2022 e parashtruar nga

A r s y e t i m

Ankuesja shtë e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas kontratës se marrëdhënies se punës me numër 297 të datës 26.01.2010 në pozitën “Nëpunëse e kontrollit”. Ankuesja F. P është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.219 të datës 16.04.2014 në pozitën “Zyrtare e pranimit te kërkesave nga zyrtar rajonale”. Ankuesja Rr. I është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si sipas Akt emërimit Nr.Prot.217 të datës 16.04.2014 në pozitën “Zyrtare per vendime dhe pagesa’ dhe ankuesi Sh. K është i punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Akt emërimit Nr.Prot.237 të datës 16.04.2014 në pozitën “Zyrtar administrativ’.



Me datën 06.09.2022 të njëjtit përmes përfaqësueses ligjore, kanë parashtruar kërkesën Nr.Prot.1913-2/2022 për tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera. Ndërsa me datën 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesën me numër të protokollit 5635/2022, për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 30.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datën 10.10.2022 kjo e fundit ka përcjellë dokumentacionin lidhur me ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 5635/2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën Nr.Prot.1913-2/2022 e datës 06.09.2022 e parashtruar nga ankuesit tek organi i punësimit; Kontratën e marrëdhënies se punës te datës 26.01.2010 me numër 297 te ankueses Z.I; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore për Z.I; Akt emërimit e ankueses F.P. Nr. Prot.219 të datës 16.04.2014; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore e ankueses për F.P; Akt emërimit e ankueses Rr.I Nr.Prot.217 te datës 16.04.2014; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore për Rr.I; Akt emërimit e ankuesit Sh.K Nr.Prot.237 të datës 16.04.2014; Autorizimin e datës 21.04.2021 nga përfaqësuesja ligjore e ankueses për Sh.K; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen ne ankesë të datës 10.10.2022 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Listën e pagave për muajin qershor dhe gusht të vitit 2022 për ankuesen Z.I; Vendimin Nr.Prot.1217/2022 të datës 06.06.2022 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses Z. I; Vërtetimin nga NJBNJ lidhur me përvojën e punës se ankueses Z. I te datës 04.10.2022; Akt emërimit Nr.Prot.240 te datës 16.04.2014 për ankuesen Z. I se bashku me përshkrimin e detyrave te punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve Z.I, F. Pr, Rr. I dhe Sh. K **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesve, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: "1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj",* andaj duke marrë parasysh konstatimin si më lartë se ankuesit përmes përfaqësueses ligjore me datën 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë fillimisht pranë organit të punësimit, ndërsa me datën 23.09.2022 fizikisht kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesit kanë parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative nga ana e organit të punësimit, kështu që ankesa e ankuesve është e palejuar në

kuptim të nenit 125 paragrafit 1 dhe nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore

në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.821/2022, datë 28.10.2022

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses me autorizim të ankuesve,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

